



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 14, datë 25.02.2022

PËR

VIJIMIN E PROÇEDURAVE TË PRISHJES SË DETYRUAR TË OBJEKTEVE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 3: 1. PALLATI ME 11 KATE, GODINA NR. 32, "USHINA", LAGJA 5, RRUGA "TEODOR RUPI", KODI GIS 22836, 2. PALLATI ME 11 KATE, GODINA NR. 8, LAGJA 5, RRUGA "STEFAN DHIMA", "NDREGJONI" SHPK, KODI GIS 23206

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 887, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore", Raportit mbi vlerësimin e aftësisë mbajtëse strukturore të objekteve ekzistuese në Njësinë Administrative nr. 3: 1. Pallati me 11 kate, godina nr.32 "Ushina", lagja 5, rruga "Teodor Rupi", kodi GIS 22836, 2. Pallati me 11 kate, godina nr.8, lagja 5, rruga "Stefan Dhima", "Ndregjoni" shpk, kodi GIS 23206, oponentat e dërguara nga Instituti i Ndërtimit Tiranë "Dërgim përgjigje për oponentin teknik të akt ekspertizës së thelluar" për të dy objektet me nr.820/6 prot, nr.1146/4 prot, të protokolluara me tonën nr. 661/36 prot datë 16.09.2021, dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Vijimin e procedurës së prishjes së detyruar të objekteve në Njësinë Administrative nr. 3:
1. Pallati me 11 kate, godina nr. 32, “Ushina”, lagja 5, rruga “Teodor Rupi”, kodi GIS 22836, 2. Pallati me 11 kate, godina nr. 8, lagja 5, rruga “Stefan Dhima”, “Ndregjoni” shpk, kodi GIS 23206, në zbatim të Raportit mbi vlerësimin e aftësisë mbajtëse strukturore dhe oponencës teknike të hartuar nga Instituti i Ndërtimit Tiranë.
2. Kryetari i Bashkisë, Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të ndjekin procedurat për aplikimin, shqyrtimin dhe miratimin e dokumentit për leje ndërtimi (prishjen e objektit të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore), sipas parashikimeve të akteve ligjore në fuqi.
3. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit merr të gjitha masat për ndërhyrjen dhe prishjen e objektit të përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi.
4. Me qëllim njoftimin e banorëve dhe palëve të interesuara, vendimi publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës, si dhe afishohet në këndin e njoftimeve pranë Njësisë Administrative Nr.3, Durrës.
5. Dërgimin e dokumentacionit pranë Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, për ndjekjen e procedurave për hartimin e PDyV pikësore për rindërtimin e tyre në të njëjtin truall nga Njësia Zbatuese, duke respektuar kondicionet urbane parashikuar ne aktet ligjore në fuqi.
6. Ngarkohen kryetari i Bashkisë, Drejtorja e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Drejtorja e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtorja e Shërbimeve Publike, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Durrës, Drejtorja e Kabinetit dhe Njësia Administrative Nr.3, Durrës për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 28.02.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURREËS

Nr. 184/prot.
2



Durrës, më 04.03.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURREËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.14 datë 25.02.2022:
“Për vijimin e procedurave të prishjes së detyruar të objekteve në Njësinë Administrative nr 3:
1:Pallati me 11 kate, Godina nr 32, “USHINA”, Lagja 5, Rr “Teodor Rupi”, Kodi GIS 22836,
2:Pallati me 11 kate, Godina nr 8, Lagja 5, Rr.”Stefan Dhima”, “Ndregjoni” Shpk, Kodi GIS
23206”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016
“Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

